



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 7473/2020
Data: 12.10.2020

**PROCESVERBALI
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e nëntë -IX- për vitin 2020 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 25.09.2020 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkryetar i Komunës), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet e Financa), Sear Dernaji (Shef për Arsim Kulturë Rini dhe Sport), Sevime Laç (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), Refet Kalisi Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Ibrahim Axhami (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i buxheti i komunës për vitin 2021 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2022-2023.
3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2019.
4. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit për vitin 2019.
5. Shqyrtimi i planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2021.
6. Shqyrtimi i raportit për vlerësimin e performances së Komunës për vitin 2019.
7. Shqyrtimi i informatës mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2020/2021.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Shqyrtimi i buxheti i komunës për vitin 2021 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2022-2023.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mallzum Qajani thekson:- në këtë vit kemi pasur një ndryshim sepse kemi pasur qarkoren e parë, të dytë dhe qarkoren e tretë por te qarkorja e tretë kemi një shkurtim buxhetorë në shumë prej 70 000 €, në krahasim me qarkoren e dytë buxhetore. Për vitin 2021 buxheti total i komunës është në shumë prej 2,520,166 €, për vitin 2022 buxheti total i komunës është në shumë prej 3,102,887 € për vitin 2023 buxheti total i komunës është në shumë prej 3,194,754 €. Materialin e kemi pranuar me kohë dhe nëse kemi ndonjë propozim apo sugjerim mund të parashtroni.

Mehmet Ballazhi thekson:- sa i përket investimeve kapitale kemi parashtruar kërkesë në fund të vitit 2017 apo 2018 për shtrimin e rrugës në lagjen Ballazhi në fshatin Pustenic. Kërkoj që kjo rrugë të hynë në planifikimet buxhetore për vitin 2021. Për vitin 2021 propozoj të hynë në planifikimet buxhetore kanalizimi i fshatit Pustenic dhe rregullimi i trafos së rrymës elektrike

Mallzum Qajani thekson:- çështja e kanalizimit është pak problem sepse duhet ta bëjmë kanalizimin që në të ardhmen mos të merremi me kanalizim në Pustenic pra të bëhet zgjidhje e mirë. Problem paraqet edhe çështja e asfaltit sepse qytetarët nuk po i lëshojnë pronat. Për çështjen e trafos e kemi diskutuar shumë herë me organet përgjegjëse.

Mehmet Ballazhi thekson:- unë mendoj që nëse nuk ka mjete buxhetore të bëhet të paktën deri te vendi i quajtur Zabeli i Bushve dhe pastaj të bëhet pjesa e tjetër e kanalizimit. Problemi është se aty ku nuk po donë me u realizuar një projekt arsyet po gjinden. Kërkesë kemi parashtruar në vitin 2017 dhe nuk është realizuar projekti dhe nuk na është dhënë arsye. Arsyeja për trafon është se nëse na e blejmë mbetet pronë e KEK-ut , mirëpo arsye duhet me gjet për me rregulluar diçka e jo për mos me rregulluar.

Kryesuesi thekson:- është mirë që të shikohen mundësit që të bartet deri me një vend të caktuar dhe në momentin që kemi mjete financiare e lidhim me kanalizimin e Hanit të Elezit.

Nexhmedin Daci thekson:- si kodë ekonomik është i paraparë me buxhet rregullimi i kanalizimeve në zonat urbane dhe rurale dhe e kemi diskutuar disa herë por është konfiguracioni pak i pa përshtatshëm, mirëpo nëse gjendet një zgjidhje nuk është problem. Sa i përket rrugës kemi parashtruar kërkesë dhe është në drejtori por kur është bërë planifikimi për shtrim me kupëza rrugicat që ishin të planifikuar me asfalt nuk i kemi përfshi dhe projekti i vitit kaluar është bartur edhe në këtë vit dhe do të shikohen mundësitë buxhetore për me realizuar.

Refet Kalisi thekson:- nuk është zgjidhje e përhershme por për momentin është mirë me i grumbulluar me një pikë e me bërë një gropë septike dhe në të ardhmen me kryer në përgjithësi. Makineri ka për me bërë pastrimin e gropës septike.

Nexhmedin Daci thekson:- propozoj që në kuadër të projekteve të hyn edhe rregullimi i parkut të qytetit, po ashtu propozoj që për projektin shtrimi i shtratit të lumit Lepenc mos të parashihen mjete financiare për vitin e ardhshëm. Te projekti për banim social për vitin e ardhshëm është mirë mos me planifikuar mjete në vitin e ardhshëm për shkak se nëse parashihet mu bërë ndërtime shkon përmes ankandit.

Mehmet Ballazhi thekson:- në bazë të marrëveshjes kolektive ka një kërkesë për pagesën e shujtave të mësimdhënësve është mirë të mendohet kjo çështje.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA BUXHETI I KOMUNËS PËR VITIN 2021 DHE PARASHIKIMET BUXHETORE PËR VITIN 2022-2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2019.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- opinionin e auditorit të përgjithshëm për komunën e Hanit të Elezit është opinion i pamodifikuar dhe në kuadër të këtij raporti janë dhënë të gjeturat dhe rekomandimet e auditorit dhe kemi shtatë rekomandime.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINACIARE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2019 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit për vitin 2019.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- komuna ka përgatitur planin se si duhet të adresohen rekomandimet e auditorit dhe pastaj do të raportojmë në kuvend për planin se sa i kemi realizuar rekomandimet.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT PËR VITIN 2019 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Shqyrtimi i planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2021.

Kryesuesi thekson:- komisionin e ka harmonizuar planin e punës së bashku me ekzekutivin e komunës dhe deri mbledhje të kuvendit të komunës mund ta plotësojmë. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Shqyrtimi i raportit për vlerësimin e performances së Komunës për vitin 2019.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mallzum Qajani thekson:- Ministria e Pushtetit Lokal për çdo vit vlerëson performancën e komunave dhe komuna e Hanit të Elezit është radhitur komuna e dytë për performacë më të mirë në nivel të komunave. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA RAPORTI I PËR VLERËSIMIN E PERFORMANCËS SË KOMUNËS PËR VITIN 2019 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

7. Shqyrtimi i informatës mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2020/2021.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sear Dernjani thekson:- në të gjitha shkollat e komunës sonë ka filluar procesi edukativo arsimorë sipas vendimit të MASHT-it. Përgatitjet të gjitha janë bërë dhe nuk ka pasur ndonjë pengesë. Përveç materialit që është përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Mehmet Ballazhi thekson:- deri ku kanë mbërri procedurat për çështjen e çerdhes dhe a është arritur numri i duhur i fëmijëve.

Mallzum Qajani thekson:- deri më tani janë lajmëruar 33 fëmijë të moshës parashkollore . Ne kemi menduar që çerdhen duhet ta themelon kuvendi i komunës, mirëpo sipas procedurave Ligjore themelimin do ta bënë Ministria e Arsimit, ndërsa pranimin teknik dhe licencen për ushtrimin e veprimtarisë së çerdhes e bënë komisioni nga e njëjta Ministri për të cilin po shpresojmë që sot apo nesër do të vjen me i bërë vizitë çerdhes dhe pastaj me lëshuar vendimin për themelim.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA INFORMATA MBI FILLIMIN E VITIT TË RI SHKOLLOR 2020/2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

8. Të ndryshme.

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në ora 11:46

Procesmbajtësi
Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava

